



## PROCESVERBALI

Mbledhja e Komitetit për Komunitete të Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur me datë: **14.10.2021** me fillim në ora **10.00**. Këtë mbledhje e kryesoi kryesuesi i Komitetit për Komunitete z. **Dusan Stojanoviq**.

**Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni të ju përshëndes të gjithëve për praninë tuaj në këtë mbledhje të Komitetit për Komunitete, përshëndes anëtarët e Komitetit për Komunitete dhe gjithë te pranishmit. Ky është takimi i katërt për vitin 2021, për takimin e sotëm i kemi këto pika të rendit të ditës:

### RENDITE

- 1. Aprovimi i procesverbali nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Informatë rreth vizitave të realizuara në shkollat e komunës se Rahovecit;**
- 3. Informatë rreth funksionimit të Qendrës arsimore në komunën e Rahovecit;**
- 4. Informatë rreth situatës se krijuar nga pandemia Covid-19;**
- 5. Të ndryshme.**

**Kryesuesi** –Të nderuar para se me qitë rendin e ditës në votim a keni diçka për të shtuar, nëse jo atëherë e qes në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës.

**1. Aprovimi i procesverbali nga mbledhja e kaluar.**

A ka dikush diçka rreth Procesverbalit të kaluar, atëherë nëse jo e qesim ne votim. Konstatoj se unanimisht aprovohet Procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë ne pikën e dytë të rendit të ditës:

**2. Informatë rreth vizitave te realizuara ne shkollat e komunës se Rahovecit.**

**Kryesuesi** – Pra para vetes e keni një informatë, që do te mundohem te ju sqaroj ne pika te shkurta. Informata gjate vizitave te realizuara me datë 17.06.2021 ne shkollën fillore te mesme te ulët „Gëzim Hamza – Piktori ne Rahovec, ne shkollën fillore te mesme te ulët „Mustaf Ibishi,, ne Kramovik, ne shkollën fillore te mesme te ulet „Hamëz Thaqi,, ne Xërxe dhe ne shkollën fillore te mesme te ulët „Katër Dëshmorët,, ne Ratkoc. Gjat vizitave te realizuara me datën 17.06.2021 ku pjesëmarrës kanë qenë drejtori i DKA-së z.Avni Morina, shefi i zyrës ZKKK-së z.Lendrit Qeli, anëtarja e Komitetit për Komunitete znj. Mirjeta Krasniqi dhe njëherë e përzgjedhur si anëtare e komisionit për vizita ne shkollat fillore dhe unë Bajram Morina kryesues i Komitetit për Komunitete ne Komunën e Rahovecit. Në shkollën fillore Gëzim Hamza ne Rahovec jemi njoftuar nga drejtori z. Enis Berisha për gjendjen e procesit mësimor e ne veçanti për te parë gjendjen e nxënësve rom ashkali dhe egjiptas. Drejtori na njoftoj se procesi mësimor është ne nivelin e mirë dhe se raportet e nxënësve te te gjitha komuniteteve janë te shkëlqyeshme. Procesi mësimor është duke vazhduar te ciklit te ultë dhe te lartë janë te rregullt dhe gjate vizitës ne u interesuam që mos ka ndonjë braktisje nga nxënësit e komitetit rom ashkali dhe egjiptas.Drejtori na informoj se deri me tani nuk ka braktisje te procesit mësimor. Pastaj shkolla fillore e mesme e ulët „Hamëz Thaqi,, në Xerxë,po ashtu edhe ne kete shkolle nga informacionet e drejtoritë shkollës se lartcekur na njoftoj për procesin mësimor te nxënësve te komunitetit rom ashkali dhe egjiptas, ku procesi mësimor është i kënaqshëm, janë te rregullt dhe bashkëpunimi me prindër është i mirë, ku na informoj se ka zhvilluar takime te shpeshta me prindërit e nxënësve si dhe janë njoftuar prindërit për vijueshmërinë e nxënësve ne shkolle. Pastaj shkolla fillore e

mesme e ulet „Mustaf Ibishi ne Kramovik, ku takimi ka qenë i frytshëm ku jemi njoftuar nga drejtori i shkollës z.Ramiz Berisha për nxënësit e komunitetit rom, egjiptas dhe ashkali për rrjedhën e procesit mësimor ne shkollë. Sipas informatave te drejtorit ne këtë shkollë, nuk asnjë braktisje nga ana e nxënësve dhe nxënësit janë te integruar mirë si dhe u njoftuam nga e personelit mësimor për suksesin e treguar ne mësimë. Pastaj shkolla fillore e mesme e ulët „Katër Dëshmoret,, ne Ratkoc, që po ashtu edhe ne kete shkollë kemi zhvilluar takimin, ku sipas informatave nga personeli i shkollës, nxënësit e vijojejnë procesin mësimor, janë te rregullt ku ne këtë shkollë funksionon edhe qendra mësimore Voraje, ku nxënësit janë te integruar mirë, pra nxënësit e komunitet rom egjiptas dhe ashkali e vijojejnë procesin ne ciklin e ulet dhe te lartë si dhe po tregojnë një sukses jashtëzakonisht te shkëlqyeshëm. Sa për informacion te shkurtër, te nderuar anëtar te komitetit për komunitete dhe ju te pranishëm ne sallë, deshta te ju informoj se një nxënëse e komunitetit egjiptas ka përfunduar klasën e nëntë dhe është regjistruar ne shkollën e mesme ne qytetin e Gjakovës, drejtimi mjekësi e përgjithshme, kështu që lirisht mund te themi procesi mësimor ne komunën tonë tek nxënësit e komunitetit rom ashkali dhe egjiptas është i kënaqshëm. Dhe ne fund e falënderoj drejtorin e DKA-së z. Avni Morina ne komunën e Rahovecit për përkrahjen dhe mbështetjen ne lëmin e arsimit dhe po ashtu edhe z. Lendrit Qeli shëf i ZKKK-së ne Rahovec i cili ka shpreh gatishmërinë që te jetë pjesëmarrës ne këto takime dhe njeherit ju falënderoj te gjithëve për kontributin tuaj. Atëherë meqë nuk kemi asnjë te lajmëruar, kalojmë ne pikën e tretë te rendit te ditës:

### **3. Informatë rreth funksionimit te qendrës arsimore ne Komunën e Rahovecit.**

Në munges te drejtorit te DKA-së, për çdo informatë rreth qendres se funksionimit mund te jap ndonjë pergjigje.

**Mirjeta Krasniqi** – Se pari përshëndetje për te gjithë koleget, sa i përket qendrës arsimore kisha kërkuar rreth numrit te nxënësve që vijojejnë ketë qendër, pastaj a ka ndryshime ne cilësinë e mësimit, pasi unë e vërej se ajo është një ndihmesë e madhe për nxënësit pasi veçse edhe unë punoj aty dhe sa ka mundësi që kjo qendër me u formua edhe ne pika tjera te komunës tone si ne Xerxe, Krushe te Madhe dhe ne Rahovec, mirëpo për këtë vit për shkak se disa nxënës kanë përfunduar klasën e nënte dhe janë regjistruar ne gjimnaze atëherë numri i nxënësve ka rënë dhe gjithsej janë duke vijuar gjithsej 24 nxënës te ciklit te ulte dhe ciklit te lartë ku vijueshmëria është e kënaqshme dhe bashkëpunimi me personelin e shkollës është shume i mirë d.m.th. këta nxënës kanë nisur me u avancue kurse per hapjen e ndonjë qendre ne fshatra tjera këtë informatë mundet me dhanë drejtori i DKA-së.

**Lendrit Qeli** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për te gjithë. Unë do te jap një informatë, pasi ne para një muaji kemi pasur një punëtori me shumicën e drejtorive te arsimit ne nivel lokal këtu ne Rahovec dhe komunat e tjera përreth, ku kemi diskutuar për ecurinë e punës që e bëjnë qendrat e komuniteteve jo shumicë ne vend. Duke marr parasysh se zyra komunale për komunitete dhe kthim luajnë një rol kyq ne te gjitha çështjet jetike që ndërlidhet me komunitetet jo shumicë ne komunën e Rahovecit, ne kemi kërkuar që rrjedhimisht kur flasim për qendrat që programet e tilla te zgjerohen edhe ne komunën e Rahovecit pra ne zonën urbane, ku një qendër e tillë ka ekzistuar me herët ne pjesën e epërme ku jetojnë pjesëtarët e komuniteteve rreth 200 anëtare dhe ne po bëjmë përpjekje që një gjë e tillë te rifunksionohet dhe tani jo vetëm me mbështetjen e donatoreve te huaj që pa marr parasysh se ekziston një udhëzim i ri per mbështetjen e qendrave dhe bashkëpunim ne nivel lokal, kështu që te shohim mundësin e zgjerimit dhe te fillon punën edhe qendra e komuniteteve ne pjesën e epërme te komunës se Rahovecit. Në vitin 2022 do te jet objektivi e zyrës komunale për komunitete që te funksionalizohet kjo qendër dhe ne kemi filluar takimet e para me fondacionin Kfos ne Kosovë, i cili do te jetë njëri prej donatoreve kryesor që do ta mbështet programin pasi kohëzgjatja e saj do te jetë me shume se 5 vjeçar. Fatkeqësisht funksionalizimi i qendrës është deshtë te bëhet prej vitit 2020 por duke marr parasysh që pandemia na ka bllokuar shume projekte sepse kemi pasur te planifikuar te realizojmë konferencën e donatoreve dhe pikërisht ne pjesën e sektorit te arsimit ka qenë e planifikuar funksionalizimi i saj, por që ne do te bëjmë përpjekje që përkundër pengesave, në vitin 2022 te funksionalizohet me mbështetjen e Kfosit. Dhe ne fund per rendësin e qendrave nuk kemi çfar te flasim sepse po shihen rezultatet dhe efektshmeria e saj ndaj nxënësve te komuniteteve që te arrihet niveli i duhur aty ku po kërkojmë te gjithë dhe përpos kësaj kjo do te mundëson edhe punësimin e disa te rinjëve dhe te rejave nga radhët e komuniteteve në cilësi te ndryshme tutor falisicator dhe ku po

shpresojmë që edhe vullneti politik prej komunës tonë do të jetë në nivelin e duhur që të mbështeten projektet e tilla.

**Kryesuesi** – Faleminderit z. Lendrit, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, vazhdojmë me pikën e radhës:

#### 4. Informatë rreth situatës së krijuar nga pandemia Covid-19.

**Rame Berisha** – sa i përket pandemisë duhet të merren masa të duhura për mbrojtjen dhe vaksinimin e popullatës që të përballojmë sa më lehtë këtë gjendje.

**Lendrit Qeli** – çështja e vaksinimit për mbrojtjen nga pandemia dhe ndihmën e ofruar për të gjitha komunitete në këtë kohë pandemie.

**Kryesuesi** – Faleminderit, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin. Të respektojmë anëtar të Komitetit për Komunitete, shefi i zyrës për komunitete z. Lendrit Qeli për kontributin tuaj dhe shihemi në takim të radhës.

#### 5. Të ndryshme.

Atëherë meqë nuk kemi asnjë koment rreth kësaj pike, unë ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe kontributin e juaj në këtë takim dhe shihemi në takim të radhës.

Procesmbajtësi

Agim Hoti



Kryesuesi i Mbledhjes

Bajram Morina